REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-
REPUBLIC OF KOSOVO
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority
Nr. prot./Prot. Br./Prot. No. 810
Njësia/Jedinica/Unit DT
Nr. shtojca/Dodata Br./Req. No.
Data/Datum/Date 28/12/2018

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

31. 12. 2018

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe konform nenit 15 të Rregullores së ARRU Nr. 07/2016 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë 23 Shtator 2016, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifor të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

# VENDIM

## për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e N.H "Ibër Lepenc" sh.a Prishtinë (ARRU/UTSH-11/08/2019), për aktivitetet themelore të shërbimit të ujit të patrajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përjashtohet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të N.H "Ibër Lepenc" sh. a, në përputhje me nenin 47 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe* në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores 07/2016 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. N.H "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjellësve Regjional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara nga ARRU-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose t'u dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit të vet; www.arru-rks.org.
5. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
6. UTSH, hyn në fuçi më 1 janar 2019 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2019 (01.01-31.12.2019).

**Këshillë juridike**: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.*

Dërguar:
1 x 1 Arkivit të ARRU
1 x 1 Kryeshefit Ekzekutiv të N.H "Ibër Lepenc"

Raif Preteni
Drejtor i ARRU

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

**ARRU/UTSH-11/08/2019**

# URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

## N.H "IBËR lEPENC" SH.A PRISHTINË PËR VITIN 2019

E aplikueshme për:

KRU "Prishtina" sh.a Prishtinë
KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë

Paasqyra e tarifave të shërbimit

NH "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë periudhës tarifore **01. 01 gjerë me 31. 12. 2019** nga procesi i rregullt tariforë tri vjeçar 2018-2020 sikurse janë dhënë në tabelën e më poshtme:

*Tabela 1: Tarifat e ujit të pa trajtuar me shumicë*

| Numri rendor | KRU-të | Njësia tarifore | Viti 2019 |
|---|---|---|---|
| 1 | Mitrovica | €/$m^3$ | *0.0163* |
| 2 | Prishtina | €/$m^3$ | *0.0364* |

*Shënim:*

*Për KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balincë të Vushtrrisë.*

*Për KRU "Prishtina" sh.a Prishtinë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën përpunimit të ujit në Drenas.*